



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Raporti i ngjarjeve, 13,14,15 prill 2024
DVP Korçë/Vihen në pranga 3 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale
DVP Elbasan – Vihen në pranga 3 shtetas, procedohen penalisht 2 të tjerë
Tiranë – Hodhën fishekzjarre, arrestohen në flagrancë 3 shtetas
Livadh – Po ndërtonte pa leje, një objekt, në tokën e një shtetasi tjetër, arrestohet 38-vjeçari



15/04/2024

Tiranë – Hodhën Fishekzjarre, Arrestohen Në Flagrancë 3 Shtetas

Tiranë

Kohët e fundit është konstatuar një shqetësim i madh dhe cenim i sigurisë publike nga përdorimi pa kriter i lëndëve piroteknike, nga qytetarë dhe subjekte të ndryshme private, kryesisht në orët e mesnatës në evente të ndryshme dhe festimeve familjare.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për goditjen dhe parandalimin e këtij fenomeni shqetësues, ka marrë një sërë masash duke monitoruar situatën në terren dhe si rezultat:

Gjatë mesnatës janë kapur në flagrancë 3 shtetas duke hedhur fishekzjarre në vende të ndryshme, konkretisht:

- Në rrugën “Arkitek Sinani”, është konstatuar shtetasi M. Xh.;
- Në rrugën “Omer Nishani”, është konstatuar shtetasi B. K.;
- Në rrugën “Spiro Cipi” është konstatuar shtetasi A. V..

Lëndët piroteknike janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale, dhe për të tre rastet e mësipërme janë kryer veprimet procedurale dhe materialet i kanë kaluar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprat penale “Prishja e qetësisë publike” dhe “Shkelja e rregullave mbi përdorimin e lëndëve plasëse”, parashikuar nga nenet 282 dhe 274 të Kodit Penal.

Ju sjellim në vëmendje se në zbatim të ligjit 73, viti 2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve pirotetenik”, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë është e vendosur për goditjen e kësaj paligjshmërie dhe bën thirrje për të gjitha subjektet që tregtojnë artikuj piroteknikë, si dhe qytetarëve, që të respektojnë kërkesat e neneve 15, 16 dhe 26 të ligjit “Për magazinimin, shitjen dhe përdorimin e artikujve piroteknikë si dhe masat e sigurisë”.

Në të gjitha rastet kur shërbimet e policisë do të konstatojnë përdorimin e lëndëve piroteknike në kundërshtim me këtë ligj, për subjektet dhe personat përgjegjës, përveç masave administrative të cilat do të shoqërohen me gjobat përkatëse dhe me sekuestrime të lëndëve piroteknike, do të procedohen penalisht edhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 282 dhe 274 të Kodit Penal.



◀ Livadh – Po ndërtonte pa leje, një objekt, në tokën e një shtetasi tjetër, arrestohet 38-vjeçari

DVP Elbasan – Vihen në pranga 3 shtetas, procedohen penalisht 2 të tjerë ▶